



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:224599

Datë: 28.04.2023

Numri i dokumentit: 04235069

C-IV-14-0703

H H adresa: Fshati B, Komuna e malishevës

Paditësi

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

E paditura

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 28.04.2023, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Hedhet si e papranueshme padia e paditësit H H e paraqitur më 07.02.2014, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datën 07.02.2014, paditësi H H ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP).

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Më 25.11.2021, gjykata ka lëshuar urdhër për paditësin duke kërkuar nga ai që brenda afatit prej 15 ditësh, të dorëzoj vendimin e atakuar të AL-së dhe të paguaj taksën gjyqësore prej 20 €. Nga

fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se urdhri i është dorëzuar paditësit më 01.12.2021, mirëpo ai nuk është përgjigj në të njëjtin.

Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme është rregulluar me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se “*në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatohet mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*”.

Neni 74.2 i Ligjit Nr.06-L-086, të Dhomës së Posaçme përcakton: Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Padia duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të ketë të bashkëngjitur një kopje të vendimit ndaj të cilit është paraqitur padia.

Nenet 33 dhe 35 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme, si dhe përcaktojnë se çfarë duhet të përmbaj padia. Me nenin 33.1 të këtij ligji është përcaktuar se padia duhet të nënshkruhet nga pala apo përfaqësuesi i tij i autorizuar. Neni 36.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parashih që një padi është e pranueshme nëse është bashkëlidhur me të një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur padia. Në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata vjen në përfundim se padia duhet të dorëzohet në gjykatë së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimit të vendimit. Dorëzimi i vendimit të atakuar nga paditësi është kriter i pranueshmërisë së padisë dhe se mosdorëzimi i vendimit nga paditësi, e bën padinë e tij të papranueshme. Megjithatë, gjykata ka ofruar edhe një mundësi paditësit për ta plotësuar këtë kusht të pranueshmërisë, ashtu që nëpërmjet urdhrit të datës 25.11.2021, ka kërkuar nga ai, dorëzimin e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit të përcaktuar në atë urdhër dhe e ka njoftuar atë pasojat e mos dorëzimit të vendimit. Nga fletëkthesa e gjykatës konstatohet se paditësi e ka pranuar urdhrin e gjykatës me 01.12.2021, por ai nuk e ka dorëzuar vendimin e atakuar me padi. Meqenëse paditësi ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve sipas urdhrit të gjykatës, u vendos që të hedhet poshtë padia si e papranueshme. Përndryshe, paditësi nuk e ka paguar as taksën gjyqësore.

Shpenzimet gjyqësore

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore. Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bart shpenzimet e veta. Në këtë çështje kontestimore, asnjëra nga palët në procedurë nuk

ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Andaj, gjykata ka vendosur që secila palë në procedurë të bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

Udhëzimi juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc.Bajram Miftari